

REPUBLIKA E KOSOVES	
KOMUNA GLOGOC	
GLOGOC MUNICIPALITY	
Numër:	24 / 06 / 2024
Nj. Origjinal:	Vlera
01-052/03-30155	

Bashkësia Lokale e Arllatit



Raporti i Dëgjimit
Publik Buxhetor

Qershor
2022



Albert Sllur


HYRJE

- Buxheti është një plan i të hyrave dhe shpenzimeve për një periudhë të caktuar kohore që hartohet dhe rivlerësohet në baza periodike. Buxheti komunal është proces themelor që lejon komunat të arrijnë shumë qëllime në rrjedhën e tyre të veprimit. Procesi i formulimit të një plani buxheti është një nga aktivitetet kryesore të çdo komune për vitin e ardhshëm me qëllim plotësimin e nevojave zhvillimore së bashku me nevojat e qytetarëve.

- Buxheti si akt më i rëndësishëm komunal shqyrtohet dhe miratohet në Kuvend Komunal në baza vjetore bazuar në parashikime afatmesme tri vjeçare. Institucionet komunale kanë kompetenca që ndikojnë në kualitetin e jetës së qytetarëve.

- Buxheti që hartohet çdo vit nga të hyrat e parasë publike, përcakton se çfarë projekte dhe shërbime do t'u ofrohen qytetarëve, andaj duhet të jetë i shpërndarë mirë dhe i konsultuar me qytetarët. Me konsolidimin e qeverisjes lokale, buxhetet komunale janë rritur dukshëm dhe janë bërë të rëndësishëm për zhvillimin e lagjeve dhe fshatrave.





Komuna e Drenasit

- Njëra ndër parimet bazë për një qeverisje të mirë është zotimi se do të mbahen dëgjime publike me qëllim të mbledhjes së prioriteteve nëpër secilin vendbanim varësisht prej kërkesave që kanë banorët, për t'i harmonizuar pastaj në draftim të politikave lokale përfshirë buxhetin.

- Ligji për Menaxhimin e Financave Publike, neni 61 e obligon Kuvendin Komunal pas pranimit të propozim buxhetit të mbajë dëgjime buxhetore dhe më pas ta shqyrtojë dhe ndryshojë (siç e shihet në arsyeshme) draft buxhetin sipas inputit të qytetarëve, ndërsa Udhëzimi Administrativ për Transparencë në Komuna ofron detaje se si duhet të informohen qytetarët për takime publike, përfshirë dëgjimet buxhetore dhe detajon procedurat për mbarevajtjen e tyre.

- Në bazë të nenit 68, të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-040, neni 61 paragrafi 2 të Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësit Nr.03/L-048, neni 17, 18 pika 1.7 dhe 19 i Statutit të Komunës së Drenasit Nr.1005 i datës 29.03.2017, Kryesuesi i Kuvendit në koordinim me Komitetin për Politikë dhe Financa dhe Drejtorinë për Buxhet dhe Financa, organizojnë dëgjime publike rreth përgatitjes së buxhetit të Komunës së Drenasit për vitin 2023.

KORNIZA AFATMESME BUXHETORE (KAB) 2023-2025

Korniza Afatmesme Buxhetore KAB është një dokument i cili miratohet në parim çdo vit nga asambleja komunale.

Ky material siguron një analizë të hollësishme të shpenzimeve publike dhe përcakton parametrat dhe prioritetet kryesore për zhvillimin e vazhdueshëm të buxheit vjetor komunal. Gjithashtu KAB siguron mekanizmat e nevojshëm për arrijen e objektivave, prioritetëve, të identifikuar në dokumentet strategjike të komunës, përmes integritimit sa më të mirë në procesin buxhetor.

- Hartimi i Kornizës Afatmesme Buxhetore përbën një detyrim për institucionet buxhetore komunale të kërkuar nga Qarkoret Buxhetore Komunale 2022/01, të lëshuara nga Ministria e Financave në pajtim me Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (LMFPF).

- Ky dokument do të jetë bazë për përcaktimin e sektorëve prioritet të zhvillimit dhe identifikimin e prioritetëve të shpërndarjes së burimeve komunale për periudhën 2023-2025.



Raporti i Dëgjimit Publik Buxhetor – Bashkësia Lokale e Arllatit



Raporti i Dëgjimit Publik Buxhetor – Bashkësia Lokale e Arllatit



Lista e nënshkrimeve - Raporti i Dëgjimit Publik Buxhetor - Bashkësia Lokale e Arllatit

LISTA E PREZANTUESËVE NË DËGJIMIN PUBLIKTOR PËR KËRKIMIN PËR MATKESË BUXHETORË
2023/2025 NË BASHKËSINË LOCALE TË ARLLATIT: Arllat, Buxhetor, Murgu, Njësi dhe Gjendje -
09.06.2023

N°	Emri dhe mbiemri	Fshat/Vendbanimi	N° e kontaktit	Marrëveshja
1	Ramir Llendo			
2	Friton Gashi	Lufshnik	044/5081302	
3	Bashir Gashi	Lufshnik	044/1231422	
4	QERIM GASHI	ARLLAT	044-354923	
5	Kemal Kuci	ARLLAT	0444553572	
6	ARMEND KUCI	ARLLAT	043978415	
7	SEKULA KUCI	ARLLAT	043978415	
8	Taulant MORA	Gjergje	043978417	
9	Valmir Kuci	Lufshnik	044-663494	
10	JOELI KUCI	Lufshnik	044-784534	
11	Anda Arllat	Murgu	043978-712	
12	Enxë Tahiri		044-500-111	
13	LAURENCE GASHI	LAURSHNIK	043-324-947	
14	Shesht Bajqis	ARLLAT	043/214-993	
15	GRU KEMAL	DEKOR	044-208 888	
16	Shesht Gashi	Vucet	044-106-500	
17	Shavit Bajqis	Arllat	043-632 724	
18	TAHIR BAJQIS	Arllat	043-589 844	
19	Shavit Bajqis	Vucet	044-233-485	
20	Shavit Bajqis	Vucet	044-233-485	
21	Shavit Bajqis	Vucet	044-233-485	
22	Shavit Bajqis	Vucet	044-233-485	
23	Shavit Bajqis	Vucet	044-233-485	

24	Shavit Bajqis	Arllat	044-842-111	
25	Shavit Bajqis	Arllat	044-842-111	
26	Shavit Bajqis	Arllat	044-842-111	
27	Shavit Bajqis	Arllat	044-842-111	
28	Shavit Bajqis	Arllat	044-842-111	
29	Shavit Bajqis	Arllat	044-842-111	
30	Shavit Bajqis	Arllat	044-842-111	
31	Shavit Bajqis	Arllat	044-842-111	
32	Shavit Bajqis	Arllat	044-842-111	
33	Shavit Bajqis	Arllat	044-842-111	
34	Shavit Bajqis	Arllat	044-842-111	
35	Shavit Bajqis	Arllat	044-842-111	
36	Shavit Bajqis	Arllat	044-842-111	
37	Shavit Bajqis	Arllat	044-842-111	
38	Shavit Bajqis	Arllat	044-842-111	
39	Shavit Bajqis	Arllat	044-842-111	
40	Shavit Bajqis	Arllat	044-842-111	
41	Shavit Bajqis	Arllat	044-842-111	
42	Shavit Bajqis	Arllat	044-842-111	
43	Shavit Bajqis	Arllat	044-842-111	
44	Shavit Bajqis	Arllat	044-842-111	




Raporti i Dëgjimit Publik Buxhetor - Bashkësia Lokale e Arllatit

Takimin e hapi Bekim Dobra - Shef i Zyrës për Komunikim me Publikun, i cili pasi përshëndeti të pranishmit i njoftoi ata se para vetës kanë draft-propozimin në formë fizike ku do të mund të marrin informatat ë përgjithshme për dëgjimet buxhetore dhe projektet buxhetore të Komunës së Drenasit.

- **Bekim Dobra** - Komuna e Drenasit ka filluar dëgjimet publike buxhetore për të marrë kërkesat e qytetarëve për projektet e vitëve vijuese 2023-2025.
- Në këto takime nuk është paraparë që të diskutohet për projektet që janë në proces e sipër.
- E ftojë kryetarin Lladrovci për një fjalë përshëndetëse
- **Kryetari Lladrovci** – përshëndetje për të gjithë, ju falenderojë për pjesëmarrje gjithë të pranishmëve, sepse prezenca juaj është kontribut shtesë për procesin e vlerësimit të Komunës ku nëpërmjet së cilës fitojmë grante.
- **Sqarohet për diskutim** – projektet në proces nuk diskutohen në këto takime sepse janë të parapara diskutimet për projektet e ardhshme në vitet vijuese.
- Kërkojë nga ju të na përcjellni për projektet që janë të dedikuara për vendbanimin tuaj.
- Nuk po e zgjati më shumë sepse këtu jam për të marrë kërkesat e juaja të përcaktujmë investimet në zonën tuaj.
- **Rregullat e takimit** – Duhet të prezantoheni paraprakisht për shkak që është duke u mbajtur procesverbail.

Raporti i Dëgjimit Publik Buxhetor - Bashkësia Lokale e Arllatit



Mentor Bujupi (banor i fshatit Arllat) – Rruga në fshatin tone Arllat, që lidhë me fshatin Gjurgjicë është shumë e nevojshme të asfaltohet prandaj kërkojë që në buxhetin e vitit të ardhshëm të jetë ky projekt për asfaltim. Poashtu kemi nevojë edhe për ndriçim të disa lagjeve sidomos në lagjen e Xhamisë së fshatit.

Kryetari Lladrovci – Nuk do të ketë rrugë të lagjeve të paasfaltuara nëpër fshatra. Të gjitha ato rrugë që janë në prone publike e që janë në interes të përgjithshëm të qytetarve do të asfaltohen. Poashtu edhe ndricimi do të kryhet gjatë këtij vitinë gjitha ato vende ku ka shtylla të betonit të cilat janë të vendosura nga KEDS.



Raporti i Dëgjimit Publik Buxhetor - Bashkësia Lokale e Arllatit



Blerim Gashi (banor i fshatit Arllat, Lagja Foniqi) – Ne si lagje Foniqi jemi e diskriminuar në projektet e Komunës së Drenasit, kemi nevojë urgjente për rregullimin e gropes septike dhe rregullimin e kanalizimit në lagje, shtyllat elektrike në të betonit nuk janë kryer nga KEDS andaj kërkojë që ato gjatë këtij viti të kryhen. Rrugët në lagje janë të paasfaltuara prandaj kërkojë që të futen në projektionet e buxhetit të vitit 2023. Vlerësojë se rrënzimi i objektit të shkollës në fshatin tone kanë qenë vendim i gabuar, kur dihet rëndësia e këtij objekti që ka nxjerrur gjenerata të tëra dhe ka shërbyer edhe në luftën e fundit të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

Kryetari Lladrovci – Këtë vit do të asfaltohen rrugicat në lagjen e juaj, për shtyllat e betonit do të bëhet kërkesë në KEDS për rregullimin e tyre, si dhe rregullimi i gropes septike dhe kanalizimit. Sa i përketë rrënzimit të objektit të shkollës ka qenë kërkesë e vet banorëve dhe shkollës për shkak të rrezikshmërisë që ka paraqitur për nxënës objekti i vjetër i shkollës.



Raporti i Dëgjimit Publik Buxhetor - Bashkësia Lokale e Arllatit


Shaban Morina (banor i fshatit Gjergjicë) – Ndjejë për obligim të sqarojë si ish drejtor i shkollës dhe mësimdhënës që nga themelimi i kësaj shkolle se rrënimi i këtij objekti ka qenë shumë i nevojshëm sepse ka qenë vatër e rrezikshmërisë për nxënësit, ka qenë një objekt tërësisht i demoluar dhe me përbërje të rrezikshme kancerogjene. Nëse kishte qenë fakti për refuzimin e rrënimt të këtij objekti ka qenë unë dhe familja ime sepse përvec tokës që është lëshuar nga familja ime kemi dhënë kontribut të jashtëzakonshëm edhe në gjitha aspektet tjera për këtë shkollë. Sa i përket planifikimit të buxhetit për vitin 2023 kemi nevojë për rregullimin e një rruge në fshatin tone, kemi nevojë për ujësjellës dhe ndricim të rrugëve publike.

Është mire që të bëni presion si institucion lokal në stacionin policor të Drenasit që të dalin në patrullim policia edhe në fshatra.

Kryetari Lladrovci – Faleminderit prof për sqarimet lidhur me rrënimin e objektit të shkollës, sa i përket kërkesave tua të gjitha do të shqyrtohen sipas prioriteteve dhe në bazë mundësive buxhetore do të jenë në planifikimin e buxhetit të vitit 2023.



Raporti i Dëgjimit Publik Buxhetor - Bashkësia Lokale e Arllatit




Jakup Bytyqi (banor i fshatit Arllat) – Kemi nevojë për 500 metra asfalt në lagjen tone sepse është në gjendje të keqe, andaj kërkojë të mbahen shënime dhe ky projekt të realizohet në vitin 2023.

Ramiz Lladrovci – E thash edhe më herët dhe po e përsërisë që të gjitha rrugët që janë publike do të kryhen gjatë këtij viti dhe në planifikim për vitin e ardhshëm.



Raporti i Dëgjimit Publik Buxhetor - Bashkësia Lokale e Arllatit




Hysni Bujuqi (banor i fshatit Arllat) – Projekti i kanalizimit që është realize në fshatin tone disa lagje nuk janë përfshirë në të prandaj kërkojë që të jetë në projekt për vitin e ardhshëm. Poashtu është shumë me rëndësi që projekti i Ujësjellësit që është kryer dhe janë vendosur gjitha gypat por të njëjtit nuk kanë ujë të pijës prandaj kërkojë që ky projekt sa më shpejt të jetë funksional sepse është jetik për banorët e fshatit Arllat.

Kryetari Lladrovci – Kanalizimet janë duke u larguar nëpër të gjitha fshatrat përmes projektit të kolektorëve në drejtim të Dobroshecit. Në këtë projekt është përfshirë dhe do të përfshihet edhe fshati Arllat me të gjitha lagjet, prandaj projekti ende nuk ka përfunduar por është në planifikim për këtë vit dhe për vitin e ardhshëm.



Raporti i Dëgjimit Publik Buxhetor - Bashkësia Lokale e Arllatit




Selim Gashi (banor i tshatit Llapushnik) – Lagja jonë Gashi nuk ka rrjet të përfunduar të kanalizimit, kemi nevojë edhe për 500 metra rrugë të asfaltohen.

Kryetari Lladrovci – Kërkesat tuaja do të merren parasysh dhe do të realizohen gjatë vitit të ardhshëm sipas mundësive buxhetore.



Raporti i Dëgjimit Publik Buxhetor - Bashkësia Lokale e Arllatit



Hysni Gashi (banor i fshatit Llapushnik) – Kërkesat për projekte I kam bërë me kohë edhe përmes protokollit por edhe gjatë këtij takimi për shqyrtimin e buxhetit kërkojë të bashkëpunoni më shumë me administratorët e fshatit. Tek shkolla e fshatit është një gjendje e keqe dhe e rrezikshme, kanalizimi tek kjo pjesë duhet të intervenohet për rregullim sepse është në gjendje teper të keqe, kemi kërkuar të bëhet rregullimi por ende nuk kemi dicka konkrete. Projektet tjera I kam paraqitur me shkresë zyrtare dhe presim përgjigje dhe realizim të tyre.

Kryetari Lladrovci – Me çështjen e kanalizimeve tek shkolla do të rregullohet ndërsa për projektet tjera të paraqitura do të shqyrtohen sipas mundësive buxhetore që ka komuna.





Raporti i Dëgjimit Publik Buxhetor - Bashkësia Lokale e Arllatit




Xhavit Bujupi (banor i fshatit Arllat) – Rruga “prita-prita” që lidhet me rrugën Sami Gashi kërkojë që të asfaltohet gjatë këtij viti sepse është shumë e nevojshme për banorët e kësaj lagje.

Kryetari Lladrovci – Po duhet ta përsërisim gjatë gjithë kohës se të gjitha rrugët që janë në interes të qytetarëve dhe janë rrugë publike do të asfaltohen gjatë këtij viti dhe vitit të ardhshëm.



Raporti i Dëgjimit Publik Buxhetor - Bashkësia Lokale e Arllatit




Sahadete Bytyqi (drejtoreshë e Shkollës “Abdedin Bujupi” në Arllat – Në këtë konsultim kisha dashur të fokusohem rreth arsimit dhe shkencës, shkolla jonë është e pajisur me kabinete mirëpo kërkesa e shkollës është për digjitalizim dhe videoprojektor e laptop në secilin klasë për të lehtësuar mësimdhënien dhe mësimnxënien. Ndërsa për investimet kapitale tek lagja e Xhamisë kërkojë të ndërtohet një sallë e sportit apo fushë sportive që të rinjtë të kenë ku të zhvillojnë aktivitete sportive. Falenderojë Komunën për përkrahjen që I ka dhënë shkollës dhe fshatit në përgjithësi.

Kryetari Lladrovci – Jemi në process të digjitalizimit të të gjitha shkollave por edhe furnizimit me kabinete shtesë, video projector dhe laptop mirëpo këto do të kryhen sipas prioriteteve dhe numrit të nxënësve në shkolla brenda mundësive buxhetore që ka Komuna e Drenasit. Sa i përket fushës sportive tek lagja e Xhamisë edhe kjo kërkesë do të shqyrtohet dhe në bazë mundësive buxhetore do të realizohet sepse I kemi dhënë prioritet që gjatë këtij mandate të ndërtojmë nga një fushë sportive në fshatra.



Raporti i Dëgjimit Publik Buxhetor - Bashkësia Lokale e Arllatit



Fehmi Krasniqi (administrator i fshatit Negoroc dhe drejtor i shkollës) – Shkolla e fshatit Negroc ka nevojë për shtim të kabineteve poashtu një fushë sportive të ndërtohet në fshat, kemi nevojë edhe për kanalizim, ndricim të rrugëve dhe trotuare.

Kryetari Lladrovci – Në shkolla jemi duke shtuar numrin e kabineteve poashtu vlen edhe për ju që fushat sportive sipas mundësive buxhetore do të ndëtojmë në vendbanime ku ka më shumë banorë. Ndërsa për rregullimin e kanalizimit vlen edhe për fshatin tuaj që jemi në proces për largimin e mbeqjeve të kanalizimeve drejt Dobroshecit. Kurse për ndricim public e kam përsëritur dhe po e përsërisë që aty ku ka shtylla betoni do të ndriqohen të gjitha lagjet në gjithë territorin e Komunës së Drenasit. Ndërsa për rregullimin e trotuareve në fshatin Negroc, do të rregullohen në vendet ku prona është publike.



Raporti i Dëgjimit Publik Buxhetor - Bashkësia Lokale e Arllatit



Valentina Gashi – Leku (banore e fshatit Llapushnik, njëherit këshilltare komunale) – Në fshatin tone kemi nevojë për asfaltimin tek nënkalimi sepse është shumë e nevojshme për shkak të frekuentimit të madh të banorëve. Poashtu ka nevojë të rregullohet parkingu tek shkolla, trotuare ku është frekuentimi më i madh i nxënësve dhe kanalizimi tek shkolla të rregullohet sepse është në gjendje të keqe.


Kryetari Lladrovci – Asfaltimi tek nënkalimi do të shqyrtohet a përbën si pjesë e rrugës magjistrale apo është prone komunale. Nëse kemi të drejtë ndërhyrje do të rregullohet. Ndërsa sa l përketë cështjes së parkingut do të paraqitet si projekt dhe sipas mundësive buxhetore do të rregullohet. Rregullimi l trotuareve nëpër vendbanime e di që është shumë i nevojshëm por në shumë raste po na del vështirë l realizueshëm për shkak se gjindet nëpër prona private. Ndërsa edhe për kanalizimin tek shkolla sic l thash parafolësit do merremi me atë çështje.




Raporti i Dëgjimit Publik Buxhetor - Bashkësia Lokale e Arllatit



***Nuk ka pyetje dhe kërkesa të tjera dhe me kaq Bekim
Dobra mbyllë takimin në Arllat.***




Raporti i Dëgjimit Publik Buxhetor - Bashkësia Lokale e Arllatit


Ramiz Eladrovci
Kryetar i Komunës së Drenasit




Shyqiri Bublaku
Drejtor i Drejtorisë për Buxhet dhe Financa


Ardyl Mziu
Zëdhënës i Komunës

Drenas,

09.06.2022